

"FINANCIMI I SHËRBIMEVE MJEDISORE PAS NDARJES ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE"

Konteksti

61 bashki janë krijuar në vend pas zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale, që prej muajit shtator 2015. Disa prej tyre janë krijuar për herë të parë nga kjo reformë, dhe disa të tjera kanë sot nën administrim një territor dhe popullsi disa herë më të madhe se më parë.

Pas ndarjes territoriale të gjitha bashkitë kanë përfunduar zbatimin e vitit të parë buxhetor për territoret e reja, të cilat i janë bashkuar rishtazi bashkive. Bashkimi i njësive të reja administrative të bashkive ka bërë që popullsitë në administrim të rriten në mënyrë drastike duke ndikuar në cilesinë dhe sasinë e ofrimit të shërbimeve mjedisore, dhe rrjedhimisht në peshën që mbart ofrimi i shërbimeve mjedisore në funksion të buxhetin total të bashkive.

Aktualisht nuk ka ndonjë studim gjithëpërfshirës në lidhje me shpërndarjen e buxhetit për ofrimin e këtyre shërbimeve, si edhe për matjen e realizimit të objektivave buxhetore për vitin 2016 si dhe për parashikimet për vitin 2017.

Objektivat

Objektivat e projektit janë:

- Përmirësimi i situatës aktuale në lidhje me ofrimin e shërbimeve mjedisore në të gjithë territorin pas reformës administrative territoriale.
- Mbështetja në arritjen e objektivave strategjik të vendosura nga qeveria.
- Vlerësimi i shpërndarjes së burimeve financiare për ofrimin e shërbimeve mjedisore.
- Përfshirjen e aktorëve kryesorë për një menaxhim efikas dhe eficient të mbetjeve të ngurta urbane.



- Ky projekt zbatohet nga rrjeti i organizatave "AULEDA", "Unë, Gruaja", "Qendra për Zhvillim Komunitar, Sot për të Ardhmen", "Tjetër Vizion", "Fondacioni Gjirokastra" dhe "Instituti i Kërkimeve Urbane" i cili është partneri lideri i rrjetit.

Aktivitetet

- 1- Vlerësimi i veprimtarisë së departamenteve që trajtojnë shërbimet mjedisore në të gjitha bashkitë e Shqipërisë.
- 2- Vlerësimi i financimit të shërbimeve mjedisore për ofrimin e shërbimit, nëpërmjet anketimit, intervistave dhe grumbullimit të të dhënave prej 61 bashkive.
- 3- Takime të thelluara me bashkitë ku operojnë organizatat partnere për validimin e të dhënave të përfutuara nga pyetësorët.
- 4- Organizimi i trajnimeve me zyrtarë të bashkisë lidhur me planifikimin financiar të shërbimeve mjedisore.
- 5- Takime me banorët e qyteteve të rrjetit për publikimin e rezultateve të dala nga takimet e thelluara me bashkitë.
- 6- Prodhimi i hartave për të gjithë territorin e Shqipërisë lidhur me shpërndarjen e buxhetit për

shërbimet mjedisore, buxhetin total të bashkive kundrejt atij mjedisor, me sistemin GIS.

- 7- Organizimi i konferencës përmblyëse në të cilën do të prezantohen gjetjet e projektit.

FAKTET KRYESORE

DONATOR:

- ✓ Agjencia e Zhvillimit të Bashkëpunimit Suedez e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë dhe REC

KOHËZGJATJA:

- ✓ 1 Maj 2017 – 31 Janar 2018

PËRFITUES:

- ✓ 61 bashki

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: info@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.